

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

Në ankesën e**AC-I-22-0573*****Paditësi*****Z A**, i përfaqësuar nga avokat B I Prishtinë.**kundër*****E paditura/Ankuesja*****NSH, "Inginiering"(në likuidim)**, të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-5560 të datës 23 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-5560 të datës 23 shtator 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 19 qershor 2014, paditësi nëpërmjet përfaqësuesit të tij parashtroj në DHPGJS-ë padi kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN129-0102, për 3 paga bruto dhe PRN129-0100 për pagat e pa paguara. Ankesa kundër vendimeve të ankimuar është paraqitur në dy forma fillimisht si ankesë kolektive e shoqëruar me ankesë individuale në emër të tani paditësit kundër vendimit të AL PRN129-0100, me kërkesë që të aprovohet kërkesa kreditore – tani kërkesëpadi e paditësit dhe të obligohet e paditura që paditësit në emër të pagave të pa paguara për periudhën janar 2007-dhjetor 2008, t'i kompensoi paditësit shumën e përgjithshme prej 5,935.60 euro më 10% kamatë. Paditësi në padi i ka bashkëngjitur: Autorizimin për përfaqësim, Kopjen e librezës së punës, Vërtetimin nga tani e paditura lidhur me ekzistimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës, (nr. prot dhe data e pa lexueshme), dhe Vendimin e ankimuar të AL, vërtetimin e dt. 31 dhjetor 2008 i lëshuara nga NSH "Ingeniering" për obligimin ndaja paditësit në emër të pagave të papaguara per periudhën 2007 dhe 2008 në shumë prej 6,337.68 euro.

Më 21 prill 2020, paditësi nëpërmjet përfaqësuesit të tij ka dorëzuar parashtrese për rregullimin e padisë kundër Vendimit PRN129-0100 me të cilin është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara dhe Vendimit PRN129-0102 prioritetin e pagës në 3 paga. Kësaj parashtrese i janë bashkëngjitur: autorizimi për përfaqësim, Llogaritja e të ardhurave personale njoftimi i të paditurës të datës 14 janar 2009, me të cilin tani paditësi ishte njoftuar se si pasojë e fillimit të procedurës së likuidimit i ndërpritej menjëherë kontrata e punës dhe " Shumat-Pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me Punëdhënësin do të mbesin përgjegjësi e Punëdhënësit, dhe kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit", Vendimi i AL PRN129-0100, dt. 15 maj 2014, dhe Vendimi i AL-së PRN129-0102 i datës 15 maj 2014 i cili nuk është përfshi në ankesën individuale të datës 19 Qershor 2014 e as parashtresën e datës 03 shkurt 2021.

Më 03 shkurt 2021, paditësi nëpërmjet përfaqësuesit të tij – dorëzoi “Parashtresë për rregullimin dhe plotësimin e padisë kundër Vendimit nr. PRN-129-0100 me të cilin është refuzuar kërkesa për pagesën e pagave të pa paguara..” me të cilën përsëri precizohet kërkesëpadia ashtu që gjykatës i kërkohet që në këtë çështje kontestimore të shqyrtoj kërkesën kreditore në emër të pagave të pa paguara në lartësi prej 5,936.60 euro me kamatë konform nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L034, dhe të detyrohet e paditura për kompensim të shpenzimeve të procedurës në lartësi prej 208,00 euro dhe kompensimin në emër të pagesës së taksave gjyqësore në lartësi prej 30,00 euro.

Me 16 mars 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë në të cilën ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar në mënyrë të drejtë kur është refuzuar kërkesa e paditësit. Tutje AKP-ja pohon se ankuesi ka dështuar të tregojë se cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit, duke pohuar se vendimi i ankimuar nuk është në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore. Tutje AKP-ja pretendon se paditësi nuk ka dorëzuar ndonjë provë para Autoritetit të Likuidimit për të dëshmuar se ai ka kërkuar pagat e pretenduara në afatin prej 3 viteve, andaj kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. AL ka bashkangjitur vendimin e AL.

Më 15 korrik 2022, paditësi-nëpërmjet përfaqësuesit të tij ka parashtruar përgjigjen në mbrojtjen e të paditurës ku nder te tjera shton se objekt i shqyrtimi dhe vendosje është ankesa kundër vendimit të AL-së PRN129-0100 i datës 15 maj 2014, në emër të kompensimit për paga të pa paguara për vitin 2007 dhe vitin 2008 në shumë të përgjithshme prej 5,935.60 euro. Ka shtuar se është i pabazuar pretendimi i të paditure se kërkesa e paditësit për paga është parashkrua. Ai konsideron se me njoftimin e për ndërprerjen e marrëdhënies së punës te dt. 14 janar 2009 është ndërprerë parashkrimi.

Më 30 gusht 2022, AKP-ja ka paraqitur përgjigjen- mbrojtjen ndaj ankesës së tani paditësit të parashtruar kundër vendimit tani të ankimuar, me q`rast i kundërshtoi në tersi pretendimet e tani paditëses, si të pa bazuar me propozimin që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetoi vendimin e Autoritetit të Likuidimit në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit Nr.06/L-086 me arsyetimin se kërkesa kreditore duhej të ishte paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saja ndaj paditësit për pagat e papaguara për të cilat pretendon paditësi për vitin 2007 dhe 2008 dhe se afati për këto duhej të ishte viti 2010 .

Me 23 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-14-5560, në pikën I ankesën e paditësit për rishikim të Aktvendimit të Autoriteti të Likuidimit e ka aprovuar si të bazuar, ka ndryshuar Aktvendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZN129-0100, i datës 15 maj 2014, ka obliguar autoritetin e Likuidimit i AKP-së që paditësi, në emër të kompensimit të pagave të pa paguara, ti paguaj shumën prej 5,935.60 euro, me kamatë 10%. Në pikën II e ka obliguar të paditurën që paditësit ti kompensoi shpenzimet e procedurës kontestimorë në shumë të përgjithshme prej 238,00 euro ku përfshihen: hartimi/padisë, kundërshtimi ndaj mbrojtjes së të paditurës dhe taksa e paguar nga paditësi dhe në pikën III e ka obliguar të paditurën, përkatësisht Autoritetin e Likuidimit që kërkesën kreditore të pranuar sipas këtij aktgjykimi ta përmbush sipas nenit 40.par.1 nën par.1.7 të Shtojcës së Ligjit.Nr.04/L034.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se padia e paditësit është e bazuar për arsye së procedurën e likuidimit të tani të paditurës ka dorëzuar tek AL një kërkesë kreditore për kompensimin në emër të pagave të pa paguara, të cilës i ka bashkëngjitur, Listën e pagave të pa paguara si dhe Letër pezullimin-Njoftimin e tani të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 14 janar 2009, sipas të cilit e paditura shprehimisht e pranon ekzistimin e detyrimit ndaj tani paditëses me konstatimin se: "Shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të

kontakoheni kur të fillojnë këto procedura". Shkalla e I-re ka theksuar se e paditura ishte në dijeni se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës/kontrata e punës si pasojë e fillimit të procedurës së likuidimit, dhe se e paditura nuk i ka kontestuar asnjërën prej këtyre provave. Shkalla e I-re ka konstatuar se AL me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e tani paditësit për kompensimin në emër të pagave të pa paguara gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur në zbatim të nenit 608 të LPB-së kërkesën kreditore të tani paditësit e ka konsideruar si të parashkruar dhe e ka refuzuar si të pa vlefshme. Autoriteti i Likuidimit me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën kreditore të tani të paditësit duhej të kishte marrë në konsiderim, fillimisht se kërkesa ka të bëjë me kompensimin në emër të pagave të pa paguara dhe duhej të kishte pranuar si provë që e ndërprente rrjedhën e parashkrimit të kërkesës kreditore. Njoftimin e tani të paditurës të datës 14 janar 2009 me të cilin e paditura ka pohuar/konfirmuar ekzistimin e detyrimit ndaj paditësit dhe sipas këtij njoftimi koha kur paditësi duhet të parqet kërkesën kreditore i është caktuar të jetë koha e fillimit të procedurës së likuidimit brenda të cilës edhe do të shqyrtohej kjo kërkesë. Shkalla e I-re kishte konstatuar se në këtë rast e paditura në datën 14 janar 2009 ka pohuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës/ shkëputjen e kontratës së punës me paditësin si pasojë e fillimit të procedurës së likuidimit dhe po ashtu kishte pohuar ekzistimin e borxhit ndaj tani paditësit, dhe me këtë është ndërprerë rrjedha e parashkrimit, ndërsa tani paditësi kërkesën kreditore e ka dorëzuar me rastin e fillimit të procedurës së likuidimit, kohë kjo e caktuar për paraqitjen e kërkesës nga vet debitori. Ndërsa sa i përket lartësisë së kërkesës kreditore kjo gjykatë e ka pranuar shumën e kërkuar nga parashtruesi/paditësi, ashtu sikurse është paraqitur nga paditësi, për arsye se e paditura nuk e ka kontestuar lartësinë e kërkesës kreditore, por këtë kërkesë e ka refuzuar me të vetmin arsyetim se e konsideron si të parashkruar. Ndërsa në bazë të nenit 62 të Ligjit Nr.06/L086 gjykata pjesërisht e aprovoi kërkesën e palës paditëse ashtu që e paditura është obliguar për kompensimin e shpenzimeve reale të përfaqësimit (hartimin e ankesës/padisë dhe përgjigjen në mbrojtjen e të paditurës).

Me 17 tetor 2022, AKP-ja përmes postës e dërgon një ankesë të afatshme kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-5560 të datës 23 shtator 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Tutje AKP-ja pohon se Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme, njëra që ndërlidhet me afatin për parashtrimin e kërkesave i cili afat i përket procedurës së dorëzimit të dëshmisë së kërkesës dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat e të drejtës e që ka të bëjë me afatin e parashkrimit të kërkesës e që në këtë rast është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të punës së Bashkuar. Tutje AKP-ja pohon se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dërguar tek paditësi ka pas për qëllim të informon atë se ai ka të drejtë të parashtrij kërkesë pranë AKP-së dhe se ky njoftim nuk i mbron të drejtat e tij dhe nuk siguron mjete ligjore që ai ka në dispozicion. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa e paditësit për paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar pasi që ajo nuk ka dorëzuar dëshmi ti ketë kërkuar këto paga brenda 3 viteve nga koha kur NSH është dashur të përmbush detyrimin e tij ndaj parashtruesit. AKP-ja ka theksuar se paditësi edhe pas kërkesës, nuk ka arritur të sigurojë të dhëna dhe dëshmi të mjaftueshme që do të paraqisnin bazë për aprovimin e kërkesës, andaj Autoriteti i likuidimit e ka refuzuar kërkesën si të pa pranueshme.

Me 21 dhjetor 2023, paditësi e dorëzoi një parashtrësë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtrësë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të cilin e konsideron si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Paditësi pretendon se në mënyrë të plotë dhe të drejtë është vërtetuar gjendja faktike me provat e administruara nga Shkalla e I-rë dhe gjithashtu në mënyrë të drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale. Paditësi me këtë parashtrësë ka kërkuar që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi C-IV.-14-5560 i datës 23 shtator 2022 si dhe të detyrohet e

paditura që të bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së avokatëve të Kosovës, për hartimin e përgjigjes në ankesën e AKP-së ndaj Aktgjykimit të shkallës së parë në shumë prej 208 euro, sipas nr. Tarifor 9.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet .

Kolegji i Apelit vëren paditësi kishte dorëzuar kërkesë me datë 11 tetor 2014 për kompensim për paga të pa paguara shumë prej 5,935.60 euro, mirëpo AL kishte refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij dhe me parashtresat tjera të dorëzuar në Shkallën e I-rë, ka theksuar se ai kërkon pagat e papaguar për periudhën 2007 dhe 2008, në shumën e përgjithshme prej 5,935.60 euro më 10% kamatë. Tutje ai ka theksuar se me datë 14 janar 2009, e ka pranuar njoftimin nga AKM-ja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si rezultat i privatizimit të NSH "Ingeniering" dhe në këtë njoftim ai ka pohuar se është theksuar se punëtorët do të njoftohen lidhur me kërkesat për pagat e pa paguara pas fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së. Tutje ai pohon se ka bërë kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me datë 11 tetor 2014, e cila pa ndonjë bazë është refuzuar kinse është parashkruar kërkesa. Paditësi padis i ka bashkëngjitur: Autorizimin për

përfaqësim, Kopjen e librezës së punës, Vërtetimin të lëshuar nga e paditura lidhur me ekzistimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës, Vendimin e ankimuar të AL, vërtetimin e dt. 31 dhjetor 2008 i lëshuara nga NSH "Ingeniering" për obligimin ndaja paditësit në emër të pagave të papaguara për periudhën 2007 dhe 2008 në shumë prej 6,337.68 euro dhe njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dt. 14 janar 2009.

Me 23 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-14-5560, në pikën I ankesën e paditësit për rishikim të Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit e ka aprovuar si të bazuar, ka ndryshuar Aktvendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZN129-0100, i datës 15 maj 2014, ka obliguar autoritetin e Likuidimit i AKP-së që paditësi, në emër të kompensimit të pagave të pa paguara, ti paguaj shumën prej 5,935.60 euro, me kamatë 10%. Në pikën II e ka obliguar të paditurën që paditësit ti kompensoi shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 238,00 euro ku përfshihen: hartimi/padisë, kundërshtimi ndaj mbrojtjes së të paditurës dhe taksa e paguar nga paditësi dhe në pikën III e ka obliguar të paditurën, përkatësisht Autoritetin e Likuidimit që kërkesën kreditore të pranuar sipas këtij aktgjykimi ta përmbush sipas nenit 40.par.1 nën par.1.7 të Shtojcës së Ligjit.Nr.04/L034.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin dhe gjetje faktike të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se kërkesa për pagat e kërkuara nuk është parashkruar siç pretendon Autoriteti i Likuidimit në vendimin e ankimuar. Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i lëshuara nga e paditura me datën 14 janar 2009 e ndërprerë parashkrimin e kërkesës për pagat e papaguara për periudhën 2007 dhe 2008 në shumë prej 5,935.60 euro, andaj ishte i gabuar konstatimi i Autoritetit të Likuidimit se kërkesa e paditësit është e parashkruar në vitin 2010.

Tutje Kolegji i Apelit vëren NSH "Ingeniering" i kishte lëshuar paditësit vërtetimin lidhur me ekzistimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës (nga dt. 03.06.1981 deri 14 01 2009), vërtetimin e dt. 31 dhjetor 2008 i lëshuara nga NSH

“Ingeniering” për obligimin ndaja paditësit në emër të pagave të papaguara për periudhën 2007 dhe 2008 në shumë prej 6,337.68 euro dhe njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dt. 14 janar 2009. Këto prova AKP-ja me mbrojtje në ankesë nuk i ka kontestuar shprehimisht, për vetëm e konstaton se kërkesa për paga është e parashkruar. Andaj një fakt i pa kontestuar, në procedurën civile konsiderohet fakt i provuar.

Kolegji i Apelit vëren se shuma e kërkesës kreditore është pranuar aq se ishte kërkesa e paditësit, ashtu sikurse është paraqitur nga paditësi, për arsye se e paditura nuk e ka kontestuar lartësinë e kërkesës kreditore.

Kolegji i Apelit i ka shqyrtuara dhe vlerësuar pretendimet ankimore të paditurës, mirëpo nuk ka gjetura se ka shkelje, dhe gjithashtu nuk mund të pajtohet me pretendimet e të paditurës se kërkesa e paditësit për paga për periudhën e lartcekur është parashkruar, pasi që të njëjtat nuk janë të argumentuara dhe nuk janë të mbështetura në Ligj.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore me datë 10 nëntor 2023, për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
